

## AKT THEMELIMI

### I

## SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### " Sun Master " SH.P.K

Sot, më datë 25.08.2022,

**Mikel Marku**, shtetas shqiptar, e ditëlindjes 19.05.1994, lindur në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035842340 dhe Nr. Personal *J40519047A* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

**Aneta Kimça**, shtetase shqiptare, e ditëlindjes 12.10.1974, lindur në Juban te qytetit të Shkodres, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034124062 dhe Nr. Personal *H46012074D* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe në përputhje me të.

### NENI 1

#### Themelimi

Emri i shoqërisë është "**Sun Master**" Sh.P.K. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Sun Master**" Sh.P.K.

### NENI 2

#### Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e "Instalim dhe montim panele fotovoltaike. Tregti me shumice e paneleve fotovoltaike. Montim ndertesash industriale. Montim dhoma frigoriferike. Tregtim te te gjithe artikujve industrial qe perdoren ne industri te lehte dhe te rende. Import dhe eksport."

### NENI 3

#### Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Sun Master**" Sh.p.k dhe kompania do ketë vulën e saj.

### NENI 4

#### Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë "Instalim dhe montim panele fotovoltaike. Tregti me shumice e paneleve fotovoltaike. Montim ndertesash industriale. Montim dhoma frigoriferike. Tregtim te te gjithe artikujve industrial qe perdoren ne industri te lehte dhe te rende. Import dhe eksport."

## NENI 5

### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodrës me adresë: Shkodër, Lagjia "Skenderbeg", Zona kadastrale 8593, Nr. Pasurie 8/312.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **1,000,000** (Një milion) lekë, i ndarë në 2 kuota, me nga 1 kuotë për secilin.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare me emrin "**Sun Master**" **Sh.P.K** zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Mikel Marku**, shtetas shqiptar, e ditëlindjes 19.05.1994, lindur në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035842340 dhe Nr. Personal *J40519047A* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% të kapitalit i cili ka vlerën 500,000 lekë.

**Aneta Kimça**, shtetase shqiptare, e ditëlindjes 12.10.1974, lindur në Juban të qytetit të Shkodrës, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034124062 dhe Nr. Personal *H46012074D* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% të kapitalit i cili ka vlerën 500,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë dhe hapjen e niptit dhe llogarise bankare. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

## NENI 7

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 8

### Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

## NENI 9

### Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet për një afat 5-vjeçar, Z. **Mikel Marku**, shtetas shqiptar, e ditëlindjes 19.05.1994, lindur në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 035842340 dhe Nr. Personal J40519047A.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

## NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmbtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

## NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

## ORTAKËT THEMELUES

**Mikel Marku**

**Aneta Kimça**

*Aneta Kimca*  
*AK*